



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 203, Datë 27.09.2024

MBI

**FILLIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRIBEN” SH.P.K. PËR  
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/4 prot., datë 25.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “DRIBEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 03.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 12.09.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k., për arsye se nga ana e saj nuk ishte kryer pagesa e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 1857/2 prot., datë 16.09.2024, duke i dhënë dhe udhëzimet përkatëse.
- Në vijim, shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s në datën 18.09.2024, pra brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës 19.07.2024, ndaj në mbështetje të parashikimeve të nenit 10, pikës 7 të Rregullores së sipërcituar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për fillimin e procedurës.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e

energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “DRIBEN” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën me Nr. 10518 Rep., Nr. 4880 Kol., datë 28.12.2023;
- Ka depozituar në ERE shkresën nga “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. nr. 6617/3 prot., datë 13.10.2022 për miratimin e lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes. Në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarje”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, e ndryshuar, por duke qenë se kanë kaluar rreth 2 dy vite nga marrja e këtij miratimi, duhet të depozitohet në ERE marrëveshja e nënshkruar me “OSSH” sh.a. si dhe të depozitohet informacion apo dokumentacion në lidhje me statusin e këtij miratimi.
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 31.08.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 MW. Rezulton se kjo VNM e ka humbur vlefshmërinë e saj (ka qenë e vlefshme deri më 31.08.2024) dhe nuk është depozituar informacion/dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve dhe nëse punimet e ndërtimit kanë filluar brenda këtij afati, në të kundërt duhet të depozitohet në ERE një VNM të re.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

#### **NENI 9**

#### **Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

*Pika 1.3. Aplikuesi duhet të depozitohet dokumentacionin financiar dhe fiskal si vijon:*

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitohet në ERE njoftimin përkatës drejtuar MIE-s në lidhje ndryshimin e vlerës së investimit dhe qëndrimin e kësaj të fundit, ose amendimin e kontratës, në rast se ka pasur një të tillë. Po ashtu, duhet të depozitohet saktësimet/sqarimet përkatëse në lidhje me shkresën dhe financimin përkatës të bankës, si dhe të dokumentojë mbulimin e 20% të vlerës së investimit, të cilin sipas planit të biznesit, ka parashikuar ta kryejë me fondet e veta.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRIBEN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**